

Komentetet e N.P"Termokos"SH.A. në Raportit Rregullativ për Përcaktimin e të Hyrave të Lejuara për sezonin 2018/2019 të Ngrohtores së qytetit Termokos/Diskutim publik/

Lidhur me dokumentin e Raportit Rregullativ për Përcaktimin e të Hyrave të Lejuara për sezonin 2018/2019 të Ngrohtores së qytetit Termokos SH.A. të cilin ZRRE e ka vënë në diskutim publik, ju përcjellim komentet në vijim:

1. Kostoja e ujit për (ri)mbushjen e sistemit të ngrohjes:

Kostot e paraqitura nga ana e NQ Termokos SH.A., dhe ato të lejuara nga ZRRE (Në €)

Kostot operative sezoni 2018/2019	Propozuar nga NQ Termokos	Lejuar nga ZRRE
Kostot variabile		
Uji	130,000.00	85,000.00

- Vlerësimi nga ZRRE- NQ Termokos ka propozuar koston në vlerë prej 130,000 €, për sasinë e parashikuar të ujit 66,500 m³ për rimbushje të sistemit; kjo kosto paraqet një rritje të vogël në krahasim me realizimin në sezonin e kaluar 2017/2018. ZRRE ka kryer vlerësimet duke u bazuar në konsumin e parashikuar dhe tarifat aktuale të shërbimeve të ujit për KRU Prishtina – për shërbimin e ujësjesit: 0.85 €/ m³ dhe për shërbimin e ujrave të zeza: 0.11 €/m³. Rrjedhimisht, bazuar në llogaritjet përkatëse, si dhe duke konsiderua një shtesë të sasisë së shpenzuar të ujit për mbushje të sistemit nga ajo e parashikuar, lejon koston e ujit prej **85,000 €**, që vlerësohet si reale dhe e mjaftueshme.

Koment nga Termokosi : Propozimi nga Termokos për koston e ujit në vlerë prej 130,000 €, është bazuar në vlerën reale sipas faturave për shpenzimet e ujit, e paraqitur në Raportimin Rregullativ për realizimet e sezonit 2017/2018 (tek shpalosja e Pasqyrës B)e cila është 129,956.86 euro.

Në kuadër të kësaj shume janë përfshirë të gjitha shpenzimet për ujin , që në Termokos përfshinë katër kategori:

- 1.Rimbushjen e sistemit të Kogjenerimit Termokos –"Kosova B" - 20,086.17 euro
- 2.Rimbushja e sistemit primar të shpërndarjes -78,385.04 euro
- 3.Termonwstacionet e distribuimit - 31,280.63 euro,
- 4.Shpenzimet e ujit në objektin administrativ të Termokosit - 205.03 euro

Total : 129,956.86 euro

Prandaj, duke u bazuar në faktin se në vlerën e propozuar nuk është e përfshirë vetëm sasia e parashikuar të ujit 66,500 m³ për rimbushje të sistemit, ju lutemi që ta aprovoni vlerën e propozuar nga Termokosi prej 130,000.00 euro në mënyrë që të mbulohet kostoja reale për shpenzimin e ujit.

2.Kostot e shitjes dhe tjera administrative

Kostot e paraqitura nga ana e NQ Termokos SH.A., dhe ato të lejuara nga ZRRE (Në €)

Kostot operative sezoni 2018/2019	Propozuar nga NQ Termokos	Lejuar nga ZRRE
Kostot fikse		
Kostot e shitjes dhe tjera administrative	1,050.000	168,611.00

Vlerësimi nga ZRRE- Kjo kosto është propozuar nga NQ Termokos në vlerë tejet të madhe 1,050,000 €; nga detajizime e ofruara vërehet se pjesa kryesore i takon nën-komponentës “shpenzimet e provizioneve të llogarive të arkëtueshme^[1]” në vlerë prej 661,389 €. Po ashtu nga deatjimet vërehet nën-komponenta “Shpenzimet e tatimit në fitim” ku është paraqitur një vlerë mjaft e madhe prej 220,000 dhe e rritur disa herë krahasuar me realizimet e sezonit të kaluar.

Nga sqarimet e NQ Termokos kuptohet se këto vlera të rritura janë të ndërlidhura me shlyerjen e borxheve gjer në vitin 2008 në përputhje me Ligjin për faljen e Borxheve Publike. ZRRE e vlerëson këtë si një operacion kontabël i domosdoshëm për të reflektuar shlyerjen e borxheve sipas ligjit në fjalë; dhe rrjedhimisht këto kosto nuk i konsideron si subjekt të shqyrtimit tarifor. Gjithashtu duhet potencuar faktin se në përputhje me dispozitat e Rregullës për vendosjen e çmimeve të energjisë termike, ZRRE e përcakton / lejon një përqindje të arsyeshme të nivelit të borxheve të këqija, e cila është kategorizuar nën kostot variabile si kostoja e borxheve të këqija. Nga sa u tha më lartë, ZRRE ka fiksuar vlerën **168,611 €**, e cila nuk i përfshin komponentet e lartëpërmendura, si vlerën e lejuar për Kostot e shitjes dhe tjera administrative.

Koment nga Termokosi:

- Sa i përket pjesës rreth “shpenzimet e provizioneve të llogarive të arkëtueshme” (apo lejimet për borxhet e këqija dhe të dyshimta), ndërmarrja Termokos bën provizionimin e llogarive të arkëtueshme më të vjetra se 6 muaj çdo fund vit, por poashtu bën edhe njohjen e të hyrave nga inkasimet e këtyre shpenzimeve nga vitet paraprake. Kurse, sa i përket “Shpenzimeve të tatimit në fitim”, kjo llogaritet sipas procedurave të Ligjit për Tatimin në të Ardhura të Korporatave. Shikuar nga raporti i vitit 2017, ku ndërmarrja kishte mbi 2 milion euro fitim (paraqitur në Raportin e Auditimit 2017) dhe duke u bazuar në Ligjin për Tatimin në të Ardhura të Korporatave për vitin vijues,

tatimi në fitim duhet të kalkulohet me 110 % e vitit paraprak. Deri në vitin e kaluar, si pasojë e faljes së borxheve (bazuar në kërkesën e konsumatorve të mundësuar nga Ligji për Faljen e Borxheve Publike), ndërmarrja ka qenë në humbje. Por nga ky vit, mosaplikimi i faljeve të borxheve ka ndikuar që menaxhmenti t'a parashikojë se do të paguaj edhe tatimin në fitim.

Prandaj bazuar në faktet e lartcekura, ju lutemi që ta aprovoni vlerën e propozuar nga Termokosi.

Me respekt,

Valdete Marevci – Dërmaku | Zyrtare e lartë për asistencë teknike

Mr.sc. Inxh.mekanike

adresa: Dardania p.n. 10000 Prishtinë, Kosovë

mob: 044 363-553 | tel: 038-543-210 ext.123 | fax: 038-541-780

email: valdete@termokos.org | www.termokos.org

